



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 17
Prishtinë, më 2 Maj 2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-303-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Mërgim Lushtaku, Verica Çeraniq, Ali Lajçi, Muharrem Nitaj, Shqipe Pantina, Avdullah Hoti, Zafir Berisha dhe Albert Kinolli.

Munguan: Faton Topalli dhe Andin Hoti.

Stafi Mbështetës: Mehmet Simnica dhe Ajet Avdullahu.

Pjesëmarrësit tjerë: Ilir Salihu, Vlora Spanca, Shkëlqim Xhema, Saranda Hysaj, Myrvet Gashi, Driton Shala- ZKA; Kreshnik Radoniqi - Gjykata Themelore Pejë, Nehat Idrizi dhe Hydajet Hyseni-GJK, Fatmir Gashi, zv.ministër i Financave dhe Shkëlzen, Morina- MF.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtura më 18.4.2018;
3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për efikasitetin e menaxhimit të lëndëve civile në Gjykatat Themelore;
4. Shqyrtimi i planit të veprimit të Qeverisë për adresimin e rekomandimeve nga Raporti i Auditimit për vitin 2016;
5. Shqyrtimi i raportit të auditimit Efektiviteti i Sistemit Informativ të Tatimit në Pronë;
6. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. **Miratimi i rendit të ditës;**

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.4.2018;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 18.4.2018, u miratua me vërejtjet e deputetit Abdullah Hoti.

3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për efikasitetin e menaxhimit të lëndëve civile në Gjykatat Themelore;

Driton Selmanaj, kryetar, njoftoi se sot do të shqyrtohet raporti i auditimit për efikasitetin e menaxhimit të lëndëve civile në gjykatat themelore. Shqyrtimi i planit të veprimit të Qeverisë për adresimin e rekomandimeve nga Raporti i auditimit për vitin 2016 dhe Shqyrtimi i raportit të auditimit për Efektivitetin e Sistemit Informativ të Tatimit në Pronë.

Avdullah Hoti: Të gjeturat kryesore të Auditorit janë tek menaxhimi i procesit të shpërndarjes së lëndëve. Auditori ka gjetur që në tri Gjykatat përdoren mënyra të ndryshme për shpërndarjen e lëndëve. Për shembull, në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe në Gjykatën Themelore të Gjilanit, ndarja e lëndëve bëhet më short në baza ditore, ndërsa në atë të Pejës, lëndët shpërndahen sipas modelit të rotacionit. Komenti i Auditorit është që secila metodë është karakterizuar me parregullsitë e veta. Opinioni im është që të harmonizohen procedurat e ndarjes së lëndëve tek gjyqtarët brenda gjykatave.

Problemi tjetër qëndron tek mënyra e pranimit të lëndëve nëpër Gjykata. Auditori gjen që në të tri Gjykatat ka mungesë të dokumentimit të të dhënave të lëndëve civile në sistemin elektronik që mundëson një menaxhim shumë efikas. Sa i përket lëndëve të pazgjidhura, mendoj që këtu është pika më problematike. Statistikat tregojnë që në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në periudhën 1999-2016, janë 15,000 lëndë të pazgjidhura, ndërsa po rritet numri i lëndëve të pazgjidhura prej vitit në vit. Sigurisht që numri i gjyqtarëve nuk është aq i madh, që i bie mbi 600 lëndë për një gjyqtarë në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në Pejë është më pak i ngarkuar, ka më pak lëndë të pazgjidhura, gjithsej janë 1855 lëndë, ose 310 lëndë për një gjyqtar. Sipas Auditorit, për vitin 2015, në rastin e Prishtinës janë 88% e lëndëve të pazgjidhura, në Pejë janë 53%, në Gjilan janë 75%, kurse kohëzgjatja e zgjidhjeve të lëndëve civile sipas statistikës, në Prishtinë është 4.6 vite, në Gjilan, 3 vite dhe në Pejë 1 vjet e 3 muaj. Arsyeja e vonësive del të jetë mungesa e stafit të nevojshëm mbështetës në Gjykatat për ti përgatitur lëndët siç duhet, në mënyrë që gjyqtarët mos të shpenzojnë shumë kohë në punë teknike, por të merren me vendimmarrje.

Një pjesë e konsiderueshme e raportit flet për aktivitetet dhe veprimet që ka ndërmarrë KGJK-ja për të rritur efikasitetin e punës, përfshi balancimin e lëndëve në mesin e gjyqtarëve, pastaj publikimi i raporteve tremujore, në mënyrë që të shihet puna e secilës Gjykatë dhe e secilit gjyqtarë.

Shqipe Pantina: Duke marrë parasysh Pejën që përzgjedhja e lëndëve bëhet në mënyrë rotative, pse Prishtina nuk e merr një praktik të tillë. A ka ndonjë planë konkret për performancën, duke marrë parasysh që Këshilli Gjyqësor vlerëson punën e gjyqtarëve dhe çka mund të bëjmë ne si deputetë, që puna juaj të jetë më efikase?

Ali Lajqi: Sa ka ndikuar reforma në sistemin e Drejtësisë në efikasitetin, në preventivat në shtimin e performancës? Cilat janë ata hapa pozitivë që ju ka sjell sistemi i reformave?

Zafir Berisha: Duke marrë parasysh që veç në Gjykatën Themelore të Prishtinës janë 15,000 lëndë

të pazgjidhura, si mendoni ta zgjidhni këtë numër kaq të madh të lëndëve ?

Nehat Idrizi, duke u përgjigjur në pyetjet e deputeteve, veçoi suksesin dhe mangësitë që po e përcjellin KGJK-në, megjithatë tha ky, ka përmirësime të dukshme, duke theksuar se gjatë rekrutimit të gjyqtarëve, rreth 1/3 e tyre i nënshtrohen vlerësimit të performancës.

Avdullah Hoti, pyeti se performanca për një gjyqtar është 27 lëndë në muaj, në të tri gjykatat ku është audituar performanca, është 17 deri 18 lëndë për një gjyqtar, tash a janë këto edhe norma ndërkombëtare për lëndë civile që kryhen?

Edhe në të tri rastet, në të tri gjykatat, numri i lëndëve të pazgjidhura është në rritje. Si është përmirësuar prej vitit 2010, kurse çdo vit po rritet numri i lëndëve të pazgjidhura. Dhe në fund, dua të theksoj se shqyrtimi i lëndëve që kthehen nga Gjykata e Apelit, duhet të shqyrtohen menjëherë, këtu është një shqetësim edhe i qytetarëve?

Muharrem Nitaj: z.Idrizi potencuat më herët keni përfshirë 60 gjyqtarë në vlerësimin e performancës së tyre, dhe ju ka rezultuar që 3 prej tyre kanë pasur performancë të dobët, që i bie që nuk është performancë në përputhje me standardet me normat që duhet ti përmbush një gjyqtar. Ju po ashtu, thatë se këta njerëz ju kanë nënshtuar një trajnimi shtesë, a do të thotë kjo që nuk kanë një performancë të kënaqshme?

A keni analizuar ndonjëherë apo bërë ndonjë studim, se cila është kostoja financiare dhe potenciali njerëzor që do t'ju duhet juve si KGJK, për të përmirësuar këtë performancë?

Albert Kinolli: Pse i keni zvarritur kaq shumë këto çështje, a ka qenë kjo pasojë e mungesës së buxhetit apo diçka tjetër? Pse nuk i keni ngritur më herët, pse u desh kaq kohë për të pritur adresimin e këtyre problemeve, mungesa e stafit e shumë probleme të tjera?

Vlora Spanca: Me Ligjin e Auditorit të Përgjithshëm dhe ZKA-së, Auditori ka mandat të kryej auditime të detyrueshme të rregullsisë dhe auditime të performancës, Auditimi të cilin e kemi kryer në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe në Gjykatat Themelore, bënë pjesë në Auditimin e performancës, i cili është një vlerësim i pavarur dhe i besueshëm, në lidhje me aktivitetet qeveritare, për të vlerësuar efikasitetin, efektivitetin dhe ekonominë e atij procesi. Ne kemi diskutuar, kemi pranuar edhe letër nga KGJK-ja dhe ky ka qenë konfirmimi ynë, do të thotë që është në pajtueshmëri të plotë me Ligjin e Auditorit të Përgjithshëm dhe ZKA-në.

Kreshnik Radoniqi: Në vitin 2009-2010, Gjykata ka qenë para një kolapsi. Një gjyqtar i ka pasur rreth 2,000 lëndë, kurse tani një gjyqtar i ka rreth 300 lëndë. Kemi përparime të dukshme në reformat ligjore e edhe në sistem, kanë dhënë rezultatin e suksesit, por edhe vetë KGJK-ja me shtimin e numrit të gjyqtarëve ka treguar sukses në zgjidhjen e këtyre lëndëve.

Driton Selmanaj, kryetar, pasi nuk pati më të paraqitur për diskutim në këtë pikë, propozoi që të vendoset që raporti të dërgohet në seancë plenare, apo të jepen vetëm rekomandimet për KGJK-në dhe Gjykatat Themelore.

Përfundim

KMFP –ja vendosi që rekomandimet për Raportin e auditimit për efikasitetin e menaxhimit të lëndëve civile në gjykatat themelore, të shqyrtohen në mbledhjen e radhës së Komisionit.

4. Shqyrtimi i planit të veprimit të Qeverisë për adresimin e rekomandimeve nga Raporti i Auditimit për vitin 2016;

Driton Selmanaj, kryetar, theksoi se është hera e parë që Qeveria ka dorëzuar në Kuvend një raport të tillë për implementim të rekomandimeve dhe me këtë e hapi diskutimin.

Fatmir Gashi, përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe zv. ministër në MF, theksoi se ky plan i veprimit nuk ka të bëjë me punën e Ministrisë së Financave, por të të gjitha Institucioneve në përgjithësi, andaj, tha se nuk e ka të drejtën të arsyetoj punën e bëre nga Institucionet, të prezantuara në këtë plan veprimi.

Përfundim

KMFP vendosi që plani i veprimit të Qeverisë për të gjeturat e Raportit të Auditimit për vitin 2016, të shqyrtohen në mbledhjen e radhës të KMFP-së.

5. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Efektivitetin e Sistemit Informativ të Tatimit në Pronë;

Driton Selmanaj, kryetar, theksoi se në këtë pikë të rendit të ditës raportues nga Komisioni është deputeti Zafir Berisha.

Zafir Berisha: Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se Sssemi informativ i tatimit në pronë nuk ka arritur të jetë plotësisht efektiv. Projekti për zhvillimin e sistemit është paraparë të përfundojë në dhjetor të vitit 2017. Mirëpo, Ministria e Financave ende nuk ka arritur të përmbush kushtet e marrëveshjes, duke rrezikuar ndërprerjen e saj, duke e vënë në pikëpyetje funksionimin dhe qëndrueshmërinë e sistemit. Nga 38 Komuna, vetëm 34 kanë shfrytëzuar sistemin Informativ të tatimit në pronë, nga kjo për të gjitha çështjet e ngritura Auditori i Përgjithshëm ka dhënë rekomandime konkrete. Tridhjetë rekomandime i adresohen Ministrisë së Financave dhe katër rekomandime i adresohen komunave. Të gjitha subjektet e audituara janë pajtuar me konkluzionet dhe rekomandimet e dhëna si dhe me afatin e paraparë për të dërguar planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve.

Fatmir Gashi, arsyetoi të gjeturat nga Raporti i Auditimit dhe premtoi se të gjitha të gjeturat e dhëna në raportin e Auditimit do të adresohen në një interval të caktuar kohor, sipas rekomandime që do të dalin nga Komisioni.

Shkelzen Morina, paraqiti në pika të shkurtra sfidat që ka Departamenti i Tatimit në Pronë, mosgatishmërinë politike që Komunitat me shumicë serbe, që ta zbatojnë sistemin e Tatimit në Pronë, përkundër që MF-ja dhe Departamenti i Tatimit në Pronë është i përgatitur për këtë.

Verica Caraniq, theksoi se në komunat në veri të vendit nuk janë duke e shfrytëzuar sistemin informativ të tatimit në pronë, megjithatë kjo është përgjegjësi e Kryetarëve të Komunave për më tepër është vendim politik. Andaj nuk mendoi se Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike mund të bëjë diçka më tepër në këtë drejtim së bashku me Ministrinë e Financave.

Përfundim

KMFP-ja, vendosi që rekomandimet për Raportin e Auditimit për Efektiviteti i Sistemit Informativ të Tatimit në Pronë, të shqyrtohen në mbledhjen e radhës të KMFP-së.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Driton Selmanaj